

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 363/22
 Br. i Prot. 363/22
 Data: 27.01.22
 Datum: 27.01.22
 No. 1

Njësia org. 02-SP
 Org. Jedinica 02-SP
 Nr. i Faqeve -02-
 Br. Stranica -02-
 No. Pages -02-

PRISHTINË / A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO ODBRANE - MINISTRY OF DEFENSE

Nr. Prot. 118
 Br. Prot. 118
 No. Prot. 118

Nr. i Faqeve 2
 Br. Stranica 2
 No. of pages 2

Data 27.01.2022
 Datum 27.01.2022
 Date 27.01.2022

Prishtine / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mbrojtjes - Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense

| | |
|-------------------------------|--|
| DATË/A: | 26.01.2022 |
| REFERENC-Ë: | 16/3/2022 |
| PËR/ZA/TO: | Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) |
| CC: | Armend MEHAJ, Ministër i Mbrojtjes Liburn ALIU, Ministër i MMPHI Afrim MURATI/Drejtor i Departamentit për Shpronësim/MMPHI Zijadin BAJQINCA, Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes/MM |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Salvador ELMAZI, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MM |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për vendim përfundimtar |

I nderuar!

Ministria e Mbrojtjes, në kuadër të planit buxhetor, ka paraparë mjete për realizimin e shpronësimit të pronave për projektin “Ndërtimi i Poligonit Kryesor të Trajnimeve” për nevoja të FSK-së - Zonat Kadastrale: Babaj i Bokës, Shishman i Bokës, Popoc, Ponoshec, Cerret dhe Devë të Komunës së Gjakovës.

Për këtë projekt kemi planifikuar mjete buxhetore për vitet fiskale 2022-2023.

Andaj, përpara procedimit të vendimit përfundimtar nga ana Juaj, me mirëkuptim kërkojmë një takim të përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të MM dhe MMPHI për këtë çështje.

Ju lutem na konfirmoni kohën dhe vendin e takimit.

Me respekt!

Faqe 1 nga 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/29
Datë: 09.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i "Poligonit Kryesor të Trajnimeve" për nevoja të FSK-së, Zonat Kadastrale: Babaj i Bokës, Shishman i Bokës, Popoc, Ponoshec, Cerret dhe Devë të Komunës së Gjakovës, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilësdo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)